



## AKT THEMELIMI

I SHOQERISE TREGETARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

## “ESPACE” SH.P.K.

**Sot ne date 22.01.2001, ne qytetin e Korces ,themelohet shoqeria tregetare me pergjegjesi te kufizuar “ESPACE”.SH.P.K. nga ortaket:**

**1-FOTO CIKO, i biri i Dhimitrit ,i dtl 1961, lindur ne Peqin dhe banues ne Korce, L.10. Rr“Llazo Opari”, Nr.18 ,me Nr.Pas. QH Nr. 284433.**

**2-ARBEN LENA, i biri i Kollit, i dtl 1969, lindur ne Korce dhe banues ne Korce , L.4. Rr“Stavri Vangjeli “,Nr.4, me Nr.Pas. 0840455**

**E cila do te ushtroje veprimtarine keto kushte:**



### NENI 1

Shoqeria tregëtare me përgjegjësi të kufizuar "ESPACE" SH.P.K. themelohet nga ortakët  
1-Foto Ciko, i biri i Dhimitrit, i dtl 1961, shtetas shqiptar  
2-Arben Lena, i biri i Kollit, i dtl 1969, shtetas shqiptar,  
ne përputhje me ligjin 7638, date 19.11.1992, "Për shoqëritë tregëtare.

### NENI 2

Shoqeria është person juridik shqiptar.  
Shoqeria ka selinë e saj në Korçë, L.10, Rr" Llaz Opari", Nr,18, ku do të jetë dhe selia e saj administrative.  
Ajo mund të krijojë seli të dyta dhe filiale të saj si në Shqipëri ashtu dhe jashtë saj në përputhje me ligjin.

### NENI 3

Shoqeria krijohet për një kohë mbi 10 vjet duke filluar nga data e regjistrimit në regjistrin tregëtar dhe mund të zgjatet me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Shoqeria merr për sipër të drejta dhe detyrime që nga momenti i themelimit dhe i regjistrimit të saj në organet kompetente.

### NENI 4

Shoqeria ka për detyrim

- Te regjistrohet në regjistrin e shoqërive tregëtare
- Te marrë lejen e ushtrimit të profesionit
- Te derdhe kuotat e kapitalit fillestar
- Te sigurojë mjetet dhe mjediset ku do të ushtrohet veprimtaria e shoqërisë
- Te sigurojë fuqi punëtore të specializuar dhe të persosë kualifikimin e tyre
- Te krijojë kushtet e nevojshme për mbrojtjen në punë të punëtoreve
- Te derdhe sigurimet e nevojshme në organet e Sigurimeve Shoqërore
- Te menaxhojë dhe ekspozojë veprimtarinë.

### NENI 5

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është veprimtaria në fushën telekomunikacioneve si operator publik në zonat rurale, tregëtimi me shumicë dhe pakicë i artikujve industriale



### NENI 6

Kapitali fillestar i shoqërisë është 100000 leke i ndarë në kuota multiple prej 1000 lekesh.

Kontributi i ortakëve në kapitalin fillestar është si më poshtë:

- |              |                    |
|--------------|--------------------|
| 1-Foto Ciko  | 50000 leke ose 50% |
| 2-Arben Lena | 50000 leke ose 50% |

Ai ndodhet i depozituar në Dhomen e Notereve Korçë dhe është i regjistruar në librin e shoqërisë në llogarinë e emërtuar "Fondi themeltar i ortakëve".



#### **NENI 7**

Fitimi neto i shoqerise do te ndahet ne baze te kuotave te kapitalit fillestar.  
Kapitali i shoqerise dhe numri i ortakeve mund te rritet me vendim te Asamblese se Ortakeve qe perfaqesojne  $\frac{3}{4}$  te votave te kapitalit themeltar.

#### **NENI 8**

Ne rast te rritjes se vlerave te kapitalit themeltar te shoqerise vlerat e kapitalit themeltar fillestar nuk rivleresohen.

Ato jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve dhe te trashgueshme ne gjini. Transferimet e kapitalit behen me akt noterial , ndryshe jane te pavlefshme.

#### **NENI 9**

Shoqeria drejtohet prej administratorit te saj , i cili do te jete z.Arben Lena, me nje mandat kohor prej dy vjetesh dhe te drejte rizgjedhjeje.

#### **NENI 10**

Shoqeria "ESPACE"SH.P.K. eshte subjekt juridik shqiptar.Ne veprimtarine e saj i nenshtrohet normave te statutit ,legjislacionit shqiptar dhe atij te huaj , ne ato raste kur me kete te fundit ka krijuar marrdhenie.

#### **NENI 11**

Ortaket dhe te punesuarit duhet te ruajne sekretimn e themelimit te shoqerise.  
Te punesuarit pergjigjen per demet qe i shkaktohen me faj shoqerise.

#### **NENI 12**

Ortaket nuk ndalohen te marrin pjese ne shoqeri te tjera qofte dhe me te njejtin objekt te veprimtarise.

#### **NENI 13**

Organi me i larte i shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve,e cila thirret ne mbledhje te rregullt te pakten njehere ne vit dhe ne menyre te jashtezakonshme ne cdo kohe me kerkesen e cdo ortaku i cili perfaqeson 10% te kapitalit.

Menyrat e thirrjes se Asamblese jane ato qe parashikohen ne statutin e shoqerise.

#### **NENI 14**

Mosmarreveshjet ose pavlefshmerite e shoqerise zgjidhen ne gjykaten kompetente.  
Gjykata kompetente ne kete rast eshte Gjykata e Rrethit Korce.

#### **NENI 15**

Akti i themelimit mbasi u lexua nga ortaket Foto Ciko dhe Arben Lena u nenshkrua para Noterit.

**ORTAKET**

**FOTO CIKO**

**ARBEN LENA**



## STATUT

SHOQERISE TREGETARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

### **“SPACE”SH.P.K.**

**Sot ne date 22.01.2001, ne qytetin e Korces ,pas themelimit te shoqerise tregetare me pergjegjesi te kufizuar “SPACE”.SH.P.K. nga ortaket:**

**1-FOTO CIKO, i biri i Dhimitrit ,i dtl 1961, lindur ne Peqin dhe banues ne Korce, L.10. Rr”Llazo Opari”, Nr.18 ,me Nr.Pas. 0840465.**

**2-ARBEN LENA, i biri i Kolit, i dtl 1969, lindur ne Korce dhe banues ne Korce , L.4. Rr”Stavri Vangjeli “,Nr.4, me Nr.Pas. QH Nr 256433**

**Te cilet deklaruan se shoqeria tregetare e krijuar prej tyre “SPACE”SH.P.K. do te ushtroje veprimtarine e saj sipas ketij statusi**



*[Handwritten signature]*

# 1-PARIME TE PERGJITHSHME

## Neni 1-Pozita juridike

Shoqeria tregtare "SPACE"SH.P.K., me anen e ketij statuti rregullon poziten e saj juridike , marrdheniet midis ortakeve dhe organeve te shoqerise , te punesuarve e personave te trete, kohën dhe menyren e veprimtarise se saj, bazuar ne ligjin Nr.7638, dt 19.11.1992, "Per shoqerite tregtare", legjislacionin ne Republiken e Shqiperise, normat e statutit dhe te kontrates se themelimit.

## Neni 2-Veprimtaria –Selia

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj ekonomike ne Republiken e Shqiperise dhe jashte saj.

Selia e shoqerise do te jete ne qytetin e Korces, L.10, Rr" Llazo Opari", Nr.18. Ajo mund te ngreje seli, dege dhe agjensi te tjera ne qytete te tjera te Shqiperise si dhe jashte territorit te saj.

## Neni 3-Objekti

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte veprimtaria ne fushen e telekomunikacioneve si operator publik ne zonat rurale, tegetim me pakice dhe shumice i artikujve industriale



## Neni 4-Emertimi

Shoqeria do te paraqitet ne qarkullim civil me emertimin "SPACE"SH.P.K. Ky do te jete edhe emertimi i shkurtuar i saj. Ajo do te kete stemen e saj te miratuar sipas rregullave.

## Neni 5-Lloji i Shoqerise

Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar "SH.P.K.".ortaket mbajne pergjegjesi per humbjet deri ne kufirin e kapitalit te investuar prej tyre.

## Neni 6-Pasurite

Pasurite e krijuara gjate veprimtarise se shoqerise jane ne pronesi te ortakeve. Ato mund te tjetersohen ,te lihen peng ose te hipotekohen vetem me miratim te Asamblese se Ortakeve.

## Neni 7-Fitimi

Fitimi i realizuar nga shoqeria ndahet midis ortakeve ne baze te kuotave te kapitalit themeltar fillestar.

- Ai eshte lirisht i disponueshem dhe i trasferueshem.
- Fitimi neto qe rezulton nga bilanci vjetor do te ndahet:
- 5 % shkon ne fondin e rezervave , i cili perdoret me miratimin e Asamblese se Ortakeve
- pjesa tjeter i vihet ne dispozicion te Asamblese se Ortakeve per tu ndare ortakeve ne kuotat e kapitalit social apo destinacione te tjera te mundshme.

*[Handwritten signature]*

*[Handwritten signature]*



## II-TE DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKEVE

### Neni 8-Te drejtat e ortakëve

Ortaku ka keto te drejta qe i realizon nepermjet vendimeve qe merr Asambleja e Ortakëve:

- Administrojnë vlerat ekonomike dhe financiare ,intelektuale te shoqërisë
- Merr pjesë vete ose me ane te perfaqesuesit ne kontrollin e rezultateve ekonomiko financiare
- Terheq e verifikon dokumentat e shoqërisë per tre vjetet e fundit
- Therret mbledhjen e Asamblese se Ortakëve , e cakton kur eshte rasti rendin e dites.
- Merr nga administratori 15 dite para mbledhjes materialet e projekt vendimet e saj

### Neni 9-Detyrat e ortakëve

Ortaku ka keto detyra kryesore:

- Nenshkruan kapitalin themelor te shoqërisë
- Derdh kuotat suplementare ne kushtet e vendosura nga statuti
- Ruan sekretin e krijimit te vlerave krijuese e materiale
- Informon per permiresimin e prodhimit e drejtimit te shoqërisë
- Respekton detyrimet qe burojnë nga Kontrata e Themelimit
- Perpiqet per gjetjen e rritjen e nivelit te specialisteve.

## III-KUSHTET EKONOMIKE

### Neni 10-Veprimtaria ekonomike

Veprimtaria e shoqërisë bazohet ne kekesat e ekonomise se tregut dhe ka per qellim fitimin.Veprimtaria ekonomike ndertohet mbi parimin e llogarise e pasqyrohet ne bilancet e saj. Llogaria e saj ,mbahet ne Shqiperi ne monedhe te vendit ose te huaj.

### Neni 11-Kapitali

Kapitali themeltar i shoqërisë eshte 100000(njeqind mije )leke.kapitali ndahet ne kuota multiple prej 1000 lekesh .

Kontributi i ortakëve ne kapitalin themeltar eshte:

- Foto Ciko 50000(pesedhjete mije) lek ose 50%
- Arben Lena 50000(pesedhjete mije )leke ose 50%

Kapitali themeltar dhe numri i ortakëve mund te rritet me vendim te Asamblese se Ortakëve qe perfaqesojne  $\frac{3}{4}$  te votave te kapitalit themeltar.

### Neni 12-Pronesia e shoqërisë

Shoqëria behet pronare e pasurise se paluajtshme qe krijohet nga momenti i themelimit te saj.

### Neni 13-Heqja dore

Ortakët mund te heqin dore ne favor e ortakëve te tjere , bashkeshortit tjetër, paraardhësve e pasardhësve.Kur heqja dore behet ne favor te personave te trete keta jane te detyruar te mos terheqin sasine e kapitalit per 6 muaj , nga data e realizimit te ketij veprimi juridik.



#### **Neni 14-Transferimi i kapitalit**

Kapitali themeltar mund te transferohet lirisht tek trashegimtaret ligjore ose testamentare, bashkeshorti ne rastine zgjidhjes se ,marteses.Ai transferohet edhe tek persona te trete.Personi qe perfiton nga transferimi detyrohet per 6 muaj te mos kerkoje terheqjen e kapitalit.

#### **Neni 15-Menyrat e transferimit.**

Ortaku qe deshiron ti tjetersoje nje te treti kuotat e tij ose nje pjese te tyre , duhet te depozitoje kerkesen e tjetersimit nepemjet nje letre rekomande duke i bere te njohur shoqerise dhe ortakeve te tjere cmimin dhe menyren e tjetersimit.

Ne rast se njeri nga ortaket heq dore qofte dhe pjeserisht nga blerja e kuotave te ofruara , kuotat e refuzuara shtohen ne favor te ortakeve te tjere ne raport me pjesemarrjen e tyre ne kapitalin themeltar.

Kuoten e ofruar per blerja ortaket detyrohen ta blejne teresisht. Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar vertetohen me akt noterial, ne te kundert jane te pa vlefshme.

#### **Neni 16-Ortaku i ri**

Nese asnje nga ortaket nuk ushtron te drejten e parablerjes dhe nese shoqeria nuk e komunikon vendimin e saj brenda 30 diteve nga depozitimi i kerkeses , tjetersuesi ka te drejte ti ofroje pjesen e vet nje te treti, por jo me cmim me te vogel nga ai i ofruar shoqerise.

Shoqeria duhet te jape pelqimin e saj per pranimin e ortakut te ri brenda afateve ligjore, ne te kundert miratimi konsiderohet i dhene.

Cdo kalim i kuotave ne kundershtim me keto norma nuk mund te regjistrohet ne librin e ortakeve.

#### **Neni 17-Zmadhimi i kapitalit**

Menyra e zmadhimit te kapitalit themeltar ne para ose ne natyre percaktohen ne ligjin "Per shoqerite tregetare". Kapitali themeltar mund te zmadhohet kur e kerkojne interesat e shoqerise duke depozituar kuota suplementare sipas vendimit te Asamblese se Ortakeve

Ne rast te zmadhimit te kapitalit cdo ortak mund te abstenoje ne nenshkrimin e kapitalit te ri duke ruajtur koutat e tij te meparshme , ose te terhiqet nga shoqeria brenda 30 diteve nga vendimi i marre per rritjen e kapitalit.

#### **Neni 18-Zvogelimi i kapitalit**

Kapitali themelor mund te zvogelohet me vendim te Asamblese se Ortakeve . Kreditoret nuk duhet te demtohen ose te ndjehen te pasigurt nga ky zvogelim, ndryshe shpallet i pavlefshem nga Gjykata.



#### **Neni 19-Nxjerrja e fitimit**

E ardhura neto qe rezulton pasi zbriten shpenzimet, pagat, shperblimet, taksat e tatimet dhe investimet perben fitim, qe ndahet midis ortakeve ne baze te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise.

#### **Neni 20-Vleresimi i pasurive.Bilanci**

Pasurite e shoqerise vleresohen ne momentin e krijimit te tyre me monedhe te vendit apo te huaj , duke u pasqyruar ne bilancin e saj.Pasurite e vleresuara nuk rivleresohen .

Bilanci vjetor paraqitet jo me vone se 31 marsi i vitit pasardhes.Forma e tij percaktohet nga Administratori ne pajtim me formen e miratuar ne Republiken e Shqiperise.





## IV-ADMINISTRIMI

### Neni 21-Asambleja e Ortakeve

Organi vendimor i shoqërisë është Asambleja e Ortakeve. Asambleja vendos me unanimitet për të gjitha problemet që shqyrton. Për çdo çështje që shqyrtohet në Asamble mbahet procesverbal, i cili qëndron gjithmone në selinë e shoqërisë.

Asambleja konsiderohet prezent me pjesëmarrjen e 51% të kapitalit themeltar. Çdo ortak ka të drejtën e një vote për çdo kuota multiple të kapitalit themeltar të nënshkruar prej tij.

Në Asamble marrin pjesë të gjithë ortakët që rezultojnë të regjistruar në librin e shoqërisë.

Çdo ortak mund të përfaqësohet nga një person tjetër në Asamble me delegim me shkrim, por jo nga administratori.

Asambleja e zakonshme thirret të pakten njëherë në vit, brenda gjashtë muajve nga mbyllja e aktivitetit financiar të shoqërisë, kurse Asambleja e jashtëzakonshme thirret për vendim urgjent që administratori e ndjen të nevojshme dhe me kërkesën e çdo ortaku që përfaqëson të pakten 10% të kapitalit social.

Në çdo rast Asambleja duhet të mbledhet jo më vonë se 5 ditë nga momenti i njoftimit të ortakeve.

### Neni 22-Kompetencat-Delegimi

Asambleja e Ortakeve shqyrton të gjitha çështjet e rëndësishme si bilancet vjetore, ndryshimet në statut, shtimin dhe pakesimin e kapitalit themeltar, emerimin dhe shkarkimin e administratorit, krijimin e filialeve dhe zyrave dhe mbylljen e veprimtarisë me anë likuidimi.

Asambleja mund të delegojë organeve me të uletë të drejta dhe detyra të kompetencës së saj, të cilat organi vartës duhet të plotësojë.

Asambleja kryesohet nga administratori, i cili zgjidhet nga ortakët deri në dorëheqje apo shkarkimin e tij, ose në mungesë të tij nga ortaku me i madh me moshe apo i zgjedhur me pelqimin e shumicës së ortakeve të pranishëm.

Asambleja e zakonshme vendos në mënyrë të vlefshme në mbledhje me votën e favorshme të ortakeve që përfaqësojnë 51% të kapitalit social, përjashtuar çështjet që ligji i shikon ndryshe në mbledhjen e dytë me pjesëmarrjen e 40% të kapitalit social dhe me shumicën e thjeshtë të votave.

Për modifikimin e statutit, rritjen apo zvogelimin e kapitalit social dhe të numrit të ortakeve është e nevojshme shumica prej 75% të votave.

Të gjitha vendimet e Asamblese verbalizohen në librin perkates.

### Neni 23-Administratori

Administratori i shoqërisë është zoti Arben Lena, i cili ka këto kompetenca:

- Miraton llogaritë ekonomike mbas përpunimit të bërë nga administrata
- Përgatit raportin vjetor të veprimtarisë së shoqërisë dhe e paraqet në Asambletë e Ortakeve
- Paraqet në Asamble projektin e ndryshimit të kapitalit themeltar
- Propozon vendin dhe kohën e hapjes së zyrave dhe filialeve
- Propozon në Asamble ose nxjerr akte në lidhje me organizimin e punës
- Propozon eksperte kontabel ose likuidatorin e shoqërisë
- Përfaqëson shoqërinë në mosmarreveshjet me administratën shtetërore, pushtetin shtetëror lokal, organet gjyqësore dhe të treta.
- Lidh kontratën individuale të punës dhe ato kolektive, si dhe me të treta.



- Organizon dhe drejton veprimtarine e shoqerise
- Paraqet raportin e prishjes se shoqerise ne asamblene e ortakeve
- Administratori zgjidhet cdo dy vjet nga assembleja, me te drejte rizgjidhjeje.



#### **Neni 24 –Drejtori menaxher**

Per kryerjen direkte te detyrave te ekzekutivit dhe te drejtimit te shoqerise ,Administratori emerom drejtor menaxher.

Drejtori menaxher qendron ne detyre deri ne doreheqjen apo zevendesimin e tij .Ai mund te shkarkohet nga administratori ne cdo kohe.

#### **Neni 25-Ekspertet kontabel**

Asambleja e ortakeve mund te emeruje nje ose me shume eksperte kontabel,funksionimi dhe kohezgjatja e tyre rregullohet nga dokumenti i emerimit dhe kontrata midis paleve.

Ndalohet caktimi si ekspert kontabel i Administratorit e personat qe jane gjini e krushqi deri ne shkalle te katert me te, si dhe pergjegjesit e zyrave te filialeve.

### **V-MARRDHENIET E PUNES**

#### **Neni 26-Punesimi**

Marrdheniet e punes rregullohen nga legjislacioni i punes e dispozitat e statutit te shoqerise.Punesimi realizohet me ane te kontrates individuale te punes.

Marrdheniet midis shoqerise dhe sindikatave rregullohen me ane te kontrates kolektive te punes.

#### **Neni 27-Kontrata e punes**

Kontrata e punes rregullon sidomos keto marrdhenie:

- Kushtet per tu punesuar ne shoqeri
- Lloji i punes qe do te kryhet, profesionet ndihmese
- Koha ditore e javore e punes
- Puna e nates , ne ditet e festave e pushimet jashte kohes normale te punes
- Shperblimi i punes per punen jashte kohes normale te punes
- Pergjegjesine e paleve pe mosrespektimine kontrates

### **VI-PRISHJA E SHOQERISE LIKUJDIMI**

#### **Neni 28-Prishja e shoqerise**

Shoqeria priset ne perfundim te afatit apo te veprimtarise per te cilen u krijuua.Ajo mund te priset para afatit perfundimtar kur:

- Nuk rezulton kontabel per dy vitet e fundit radhazi
- Vendos Gjykata kompetente
- Me kerkesen e Asamblese se ortakeve
- Me kerkese te ortakeve qe perfaqesojne me shume se 10% te kapitalit themeltar



### **Neni 29-Likujdimi**

Me prishjen e shoqerise vendoset likujdimi i saj. Asambleja e Ortakeve cakton likujdatorin ose disa likujdatore duke percaktuar fuqite dhe pagesen per secilin.  
Gjate likujdimit shoqeria mban anash shenimin”shoqeri ne likujdim e siper”

### **Neni 30-Mbyllja e likujdimit**

Likujdimi vendoset nga Asambleja e Ortakeve , e cila mblidhet per te kontrolluar rregullshmerine e likujdimit ,bilancin e likujdimit heqjen e mandatit te likujdatoreve, me kerkesen e tyre.Mbledhja mund te thirret edhe me vendim nga Gjykata ne se likujdatori nuk e kerkon

Per cdo rast konflikti me te tretet dhe nepermjet ortakeve, ne rast te mosarritjes se konsensusit, cdonjeri gezon te drejten e prezantimit te ceshtjes organeve gjyqesore kompetente.

Me mbylljen e likujdimit dhe miratimin e tij shoqeria i jep fund veprimtarise.

Aktet e mbljes se likujdimit e llogarite perfundimitare depozitohen ne regjistrin tregetar, duke u cregjistruar shoqeria.

## **VII-DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

### **Neni 31-Pergjegjesite**

Administratori mban pergjegjesi individuale per veprimtarine e tij para Mbledhjes se Asamblese se Ortakeve dhe pergjigjet per demet qe i vijne shoqerise nga veprimet e fajshme te tij.

Eksperti kontabel pergjigjet per demet qe i vijne shoqerise nga mbajtja e gabuar e llogarive ose verifikimi i gabuar i tyre.

Punonjesit dhe personeli drejtues admistrativ mban pergjegjesi civile per demet qe me faj i shkaktohen shoqerise e pergjegjesi penale kur me dashje shkelin detyrat e ngarkuara.

### **Neni 32-Protokolli**

Te gjitha vendimet, kundershimitet dhe sugjerimet e organeve drejtuese te ortakeve te shoqerise , do te evidentohen ne nje liber protokolli i cili do te kete vlere ruajtje sipas ligjit mbi arkivat.

### **Neni 33-Vula**

Shoqeria ka vulen e saj ,stema e sciles permban shkrimet e nevojshme qe tregojne emrine shoqerise.

Ndalohet konkurrenca midis ortakeve per te njejten veprimtari.

### **Neni 34-Hyrja ne fuqi**

Statuti hyn ne fuqi mbas regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregetar sipas vendimit te Gjykates se Rrethit Tirane.

Statuti pasi u lexua nga ortaket u nenshkrua pa verejtje para noterit.

**ORTAKET**

**FOTO CIKO**

**ARBEN LENA**